


EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7852
E shtunë, 3 gusht 2024
Çmimi 0.50

Incidenti me presidenten
në Shkup, pakujdesi e
autoriteteve ose provokim

FACE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

QUINTI DHE NATO-ja S'E MBËSHTESIN HAPJEN E URËS SË IBRIT, KURTI NGUL KËMBË NË HAPJEN E SAJ

FACE 3



Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka ngulur këmbë në hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë, me gjithë kundërshtimin e vendeve të Quintit dhe NATO-s. Gjatë një takimi të premtën në Prishtinë, Kurti ua paraqiti

përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të Quintit dhe BE-së planin e qeverisë për hapjen e urës së Mitrovicës mbi lumën Ibër, njoftoi zyra e tij në një komunikatë për medie. "Ura duhet të hapet. Ajo është në shërbim të të gjithëve. Nuk

është kundër askujt. Liria e lëvizjes dhe sundimi i ligjit nuk e rrezikojnë paqen dhe sigurinë, përkundrazi", thuhet në komunikatën e Qeverisë së Kosovës pas takimit me përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quintit dhe BE-së

KOSOVËS I SHTOHEN EDHE 448 POLICË TË RINJ

F.5



TAHIRI: SESIONI PRANVEROR I KUVENDIT, PERIUDHË E FITOREVE TË BETEJAVE KUSHTETUESE TË PDK-së

F.3



NËNSHKRUHEN DY MARRËVESHJE ME VLERË 60 MILIONË EURO PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË ENERGJISË SOLARE

F.8

HYKOLLI: JEMI TË SHOQËSUAR ME RAPORTET E REJA TË PARAQITURA NGA ZKA-ja PËRKITAZI ME GJETJET NË AKP

F.8

SPORT



DISTRIA KRASNIQI NË FOKUSIN E IJF-së PËR SUKSESET NË TOKIO DHE PARIS

F.10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mok: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Kurmasheva, Gershkovich e Whelan kthehen në ShBA pas këmbimit të të burgosurve me Rusinë

WASHINGTON, 2 GUSHT - Alsu Kurmasheva, Evan Gershkovich, dhe Paul Whelan – tre qytetarë amerikanë të liruar në këmbimin më të madh të të burgosurve prej Luftës së Ftohtë – janë kthyer në Shtetet e Bashkuara më 1 gusht. Ata u mirëpritën nga presidenti amerikan Joe Biden dhe familjet e tyre në Joint Base Andrews, pranë Uashington DC. Ata ishin pjesë e një grupi prej 16 të burgosurve që Rusia dhe aleatja e saj e ngushtë, Bjellorusia, i liruan në këmbim për tetë rusët që po mbaheshin nga Shtetet e Bashkuara dhe disa vende të tjera.

Bideni, i cili më herët gjatë ditës e cilësoi historik këmbimin gjatë një konference për media në Shtëpinë e Bardhë, i mirëpriti ata së bashku me nënpresidenten Kamala Harris, teksa anëtarët e familjeve, kolegët dhe mediet vështronin. Kurmasheva, gazetare e Radios Evropa e Lirë, Gershkovich, gazetar i "Wall Street Journal" dhe Whelan, ish-marins

amerikan, janë që të gjithë qytetarë amerikanë.

Whelan ishte i pari që doli nga avioni dhe u përqaftua menjëherë nga Bideni, ndërsa pas tij doli Gershkovich, i cili u mirëpriti me duartrokitje teksa e përqaftoi presidentin.

Kurmasheva ishte e fundit nga kjo treshe që doli nga avioni dhe, edhe ajo, u përqaftua nga Bideni dhe u mirëpriti me duartrokitje nga turma e mbledhur atje.

Gershkovich, 32 vjeç, u arrestua në Rusi në mars 2023 derisa po raportonte gjatë një udhëtimi në Jekaterinburg. Ai u dënua në korrik me 16 vjet burgim për akuzat për spiunazh, të cilat u mohuan nga Shtetet e Bashkuara dhe punëdhënësi i tij, "Wall Street Journal". "Nuk është keq", tha ai kur u pyet nga gazetarët se si ndihej që më në fund u kthye në shtëpi, pasi i kaloi 491 ditë në burg.

Kurmasheva, 47-vjeçarja, nënë e dy fëmijëve, u arrestua në Kazan në tetor 2022 dhe fillimisht u akuzua se dështoi të regjistrohej si "agjente e huaj" në bazë të



ligjit ndëshkues rus, i cili i ka në shënjestër gazetarët, aktivistët e shoqërisë civile dhe të tjerët. Ajo u akuzua më vonë për

shpërndarjen e informatave të rrejshme për ushtrinë ruse dhe u dënua me gjashtë vjet e gjysmë burgim.

I pyetur se çfarë do t'i thoshte Putin pas këmbimit, presidenti u përgjigj: "Mjaft", duke iu referuar futjes së amerikanëve në parburgim për akuzat të dyshimta. "Nuk pajtohem me këtë idenë... lini këta njerëz të kalben në burg, sepse njerëz të tjerë mund të kapen", shtoi presidenti, duke i hedhur poshtë kritikën se këmbime të tilla mund të ndikojnë që amerikanë të tjerë të burgosen.

Kur njoftoi për këmbimin e të burgosurve, Bideni e kritikoi Rusinë për mbajtjen e "gryqeve të kurdisura" që çuan në burgosjen e Gershkovichut, Whelanit dhe Kurmashevës, duke thënë se "që të tre u akuzuan rrejshëm se ishin spiunë".

Më herët, Bideni tha se u nevojitën "koncesione të rëndësishme" nga Gjermania për këmbimin e të burgosurve,

pasi ajo e liron kolonelin e FSB-së, Vadim Krasikov, që ishte dënua për vrasjen e një ish-militanti çeçen në Berlin më 2019.

Në këmbim u përfshi edhe Vladimir Kara-Murza, me shtetësi ruse dhe britanike, i cili ishte burgosur për shkak të komenteve kritike për pushtimin e plotë të Ukrainës nga Rusia. "Alsu, Evan, Paul, Vladimir dhe të tjerë, ju e kenë vendin në shtëpitë e juaja me familjet dhe me më të dashurit tuaj", shkroi në X presidenti i Këshillit të BE-së, Charles Michel.

Pasi të kenë kaluar kohë me familjet dhe miqtë e tyre, Kurmasheva, Gershkovich dhe Whelan do të udhëtojnë për San Antonio, Teksas, për tretman mjekësor dhe për t'u marrë në pyetje nga zyrtarët amerikanë.

Lirimi i 16 personave nga Rusia dhe Bjellorusia përfshiu pesë qytetarë gjermanë dhe shtatë rusë, të cilët ishin të burgosur politikë në vendet e tyre.



Turqia e bllokoi qasjen në "Instagram", s'tregon arsyen

ANKARA, 2 GUSHT - Turqia e ka bllokuar qasjen në platformën sociale "Instagram", njoftoi të premtën Autoriteti për Teknologji dhe Komunikim i Turqisë (BTK).

BTK nuk ka shpjeguar arsyet e as sa do të zgjasë kjo ndalesë, e cila pamundëson qasjen edhe në aplikacionin e Instagramit në telefonat mobilë.

Ky vendim vjen dy ditë pasi

zyrtari turk për komunikim, Fahrettin Altun, e kritikoi "Instagram"-in për, siç tha, ndalimin e postimeve ngushëlluese për vrasjen e Ismail Haniyeh, liderit politik të Hamasit, grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian. "Kjo është thjesht censurë", tha Altun, drejtor për komunikim në Presidencën

e Turqisë, duke thënë se "Instagram"-i nuk kishte përmendur ndonjë shkelje në rregullat e saj kur e kishte marrë atë vendim.

Pronarja e "Instagram"-it, Meta, nuk ka komentuar as për ndalesën e as për komentet e Altunit. Autoriteti për Teknologji dhe Komunikim i Turqisë (BTK) e publikoi vendimin më 2 gusht në uebsajtin e saj.



Tahiri: Sesionit pranveror i Kuvendit, periudhë e fitoreve të betejave kushtetuese të PDK-së

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Abelard Tahiri, pas përmbylljes së sesionit pranveror të Kuvendit, ka thënë se ishte periudhë e fitoreve të betejave kushtetuese të PDK-së në mbrojtje të interesit publik dhe vlerave të shtetit demokratik.

Tahiri në një konferencë për medie tha se GP i PDK-së është angazhuar në vazhdimësi që t'i ndalë projektet dhe iniciativat e dëmshme të qeverisë Kurti, e cila e ka shpërfillur Kuvendin dhe e ka braktisur përgjegjësinë dhe llogaridhënien para qytetarëve. "Sesionit pranveror ka filluar në fund të janarit të këtij viti me mbi 30 pika të papërfunduara të sesionit vjeshtor dhe po e mbylлим këtë sesion me 30 pika të papërfunduara. Kjo tregon për efikasitetin e punës së këtij Kuvendi", theksoi ai.

Tahiri ka treguar se PDK-ja ka fituar betejat kushtetuese për anulimin e Ligjit për Byronë Shtetërore dhe për ndryshimin e



Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, si dhe ka dërguar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Këshillin Prokurorial dhe Ligjin për Komisionin e Pavarur të Medieve. "Beteja e parë që ka të bëjë me Ligjin për Byronë Shtetërore për

Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme ishte një iniciativë që binte ndesh me rendin tonë kushtetues që Gjykata Kushtetuese u dha të drejtë pretendimeve tona. Dhe, në anën tjetër, ishte edhe Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, e

cila ishte një iniciativë për ta rrënuar shërbimin civil në Republikën e Kosovës, një investim 20-vjeçar nga fondet tona si taksapagues të shtetit dhe nga fondet e BE", tha Tahiri. Ai ka shtuar se PDK-ja ka propozuar themelimin e katër

Komisioneve Hetimore, atë për shlyerjen e borxheve milionëshe ambalazhuesve të ujit nga Ministria e Mjedisit, për zhdukjen e mostrave të Astrit Deharit dhe zjarret në IML, për kontratat njëburimore nëpër ministri dhe në ndërmarrje publike qendrore, për subvencionimin e teksteve shkollore. "Gjatë këtij sesioni GP i PDK-së ka iniciuar katër Komisionet Hetimore, ku vetëm një prej tyre kemi arritur ta themelojmë [për subvencionimin e teksteve shkollore] dhe në fund edhe puna e tij na është bllokuar", tha Tahiri.

Gjatë sesionit pranveror ai ka theksuar se PDK-ja ka iniciuar disa debate parlamentare, atë për arratisjen e personave të dënuar, atë për adresimin e gjetjeve të Raportit të Departamentit Amerikan të Shtetit, për emigrimin e qytetarëve nga Republika e Kosovës, për tërheqjen e tri projektligjeve kundërkushtetuese nga shqyrtimi në Kuvend, si dhe për shkarkimin e Bordit të RTK-së.

Kosovës i shtohen edhe 448 policë të rinj

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 2 GUSHT - Të premtën në sallën "1 Tetori" në Prishtinë është mbajtur ceremonia e diplomimit të gjeneratës së 60 të Policisë së Republikës së Kosovës, ku diplomuan 448 policë të rinj. Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë personalitete të larta shtetërore dhe ndërkombëtare, familjarë të zyrtarëve policorë që diplomuan dhe eprorë të Policisë së Kosovës. Me këtë rast, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se policia po shton dhe forcon radhët e saj duke qenë në nivelin më të lartë të detyrës për sundimin e ligjit dhe ruajtjen e sovranitetit e integritetit të vendit. "Policia e Kosovës këtë vit mbush 25 vjet. Sot u shtohen radhëve të saj edhe 448 policë të rinj. Themelimi i policisë përkon me çlirimin e vendit. Zhvillimi i saj ecën krah për krah me përparimin e shtetit. Gjenerata jubilarë e 60, në të cilën çdo e pesta është grua, e ku si në çdo gjeneratë tjetër ka edhe kadetë të diplomuar nga radhët e komuniteteve joshumicë, do të shërbejë me nder dhe dinjitet, pa dallim e për të gjithë, si vlera, parime dhe identitet i policisë sonë. Përkushtimit profesional për të shërbyer ia kemi dhënë dhe mbështetjen institucionale që meriton. Policia ka gati 50 % më shumë buxhet sesa kishte para qeverisjes sonë. Kemi bërë investime prej afër 17 milionë eurosh në pajisje policore logjistike, 3 milionë euro në

rregullimin dhe ndërtimin e objekteve policore, gati 8 milionë euro në flotën automjeteve dhe autobлиндave. Sepse misionin për vendin tonë e kemi të përbashkët. Çdo sfidë e çdo sukses do ta kalojmë bashkë", ka deklaruar Kurti.


Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se policia e vendit tonë me profesionalizmin e tyre ka arritur ta ngrehë këtë institucion si më të besueshmin për qytetarët e Kosovës.

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha, ka thënë se diplomimi i kësaj gjenerate tregon përkushtimin e tyre për t'i tejkaluar të gjitha sfidat për t'u bërë pjesë e Policisë së Kosovës. Ai potencoi se prioritet për Policinë e Kosovës është përmbyllja e standardeve, përfaqësimi i të gjitha komuniteteve, diversiteti etnik dhe ai gjinor.

Zëdhënësi i gjeneratës së 60 të Policisë së Kosovës, Florian Shala, u shpreh se ky moment i diplomimit është dëshmi e përkushtimit dhe përgjegjësisë për t'i përmbyllur me nder dhe dinjitet detyrat që i presin. Ai u zotua se do të punojnë me përkushtim për ta ruajtur besimin që e kanë qytetarët në Policinë e Kosovës. Policia e Kosovës që nga themelimi është institucioni më i rëndësishëm shtetëror që kujdeset për mbrojtjen dhe sigurinë e rendit në vend.

PK-ja ka filluar punën më 6 shtator të vitit 1999, ndërsa sivjet do ta shënojë 25-vjetorin e themelimit.





Quinti dhe NATO-ja s'e mbështesin hapjen e urës së Ibrit, Kurti ngul këmbë në hapjen e saj

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka ngulur këmbë në hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë, me gjithë kundërshtimin e vendeve të Quintit dhe NATO-s. Gjatë një takimi të premtën në Prishtinë, Kurti ua paraqiti përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të Quintit dhe BE-së planin e qeverisë për hapjen e urës së Mitrovicës mbi lumin Ibër, njoftoi zyra e tij në një komunikatë për medie. “Ura duhet të hapet. Ajo është në shërbim të të gjithëve. Nuk është kundër askujt. Liria e lëvizjes dhe sundimi i ligjit nuk e rrezikojnë paqen dhe sigurinë, përkundrazi”, thuhet në komunikatën e Qeverisë së Kosovës pas takimit me përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të Quintit dhe BE-së

fundit të vitit të kaluar e sidomos në gjashtëmuorin e parë të këtij viti, si dëshmi e vullnetit dhe interesimit të tyre për integrim të qëndrueshëm. Ky takim u zhvillua pikërisht 8 vjet pas diskutimeve që ishin mbajtur më 2 gusht 2016 në Bruksel në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Urën e Mitrovicës në kuadër të dialogut në Bruksel, e që u pasua pastaj me planin e Bashkimit Evropian për hapjen e urës së Mitrovicës për këmbësorë dhe automjete në dy drejtime.

Kryeministri Kurti paraqiti para përfaqësuesve diplomatikë të shteteve të Quintit dhe BE-së planin e qeverisë për hapjen e urës së Mitrovicës mbi lumin Ibër. “Plani parasheh testimet për stabilitetin infrastrukturor të urës, vlerësimin e rrezikut dhe rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, rivitalizimin vizual të urës me qasje në urë për të gjithë, diskutimet me qytetarë dhe grupe të interesit si dhe fushatën e informimit gjithëpërfshirës mbi përfitimet dhe qëllimet e hapjes së urës. Konsultimet dhe koordinimi vazhdojnë. Siç thuhet në planin e Bashkimit Evropian për rivitalizimin e urës, ura e Mitrovicës mbi Ibër do të bëhet simbol i normalizimit të marrëdhënieve në Kosovë. Në po atë plan thuhet se

‘rivitalizimi i saj do të kontribuojë shumë në lehtësimin e kontakteve ndërmjet të gjithë qytetarëve të Mitrovicës së Veriut dhe Jugut dhe kështu do të kontribuojë në shkëmbime dhe mirëkuptim’. Andaj ura duhet të hapet. Ajo është në shërbim të të gjithëve. Nuk është kundër askujt. Liria e lëvizjes dhe sundimi i ligjit nuk e rrezikojnë paqen dhe sigurinë, përkundrazi”, është bërë me dije në komunikatën e Qeverisë së Kosovës.

Më tej theksohet se ura është simbol i lëvizjes së lirë, e që është vlerë dhe liri themelore e Bashkimit Evropian. “Ura është simbol i integritetit, e që është punë e përbashkët e Kosovës me partnerët tanë. Qeveria është edhe për lëvizje të lirë edhe për integrim të qytetarëve”, është theksuar në komunikatën e qeverisë.

Ura, aktualisht, është e hapur vetëm për këmbësorë ndonëse, në kuadër të dialogut, është rënë dakord të hapet edhe për trafik.

Në urën mbi Ibër patrollojnë ushtarët italianë të KFOR-it, misionit të NATO-s në Kosovë, ndërsa afër janë edhe pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Nga sektori civil në Kosovë thonë se faktor kyç në hapjen e urës është, në fakt, KFOR-i, sepse ai duhet t'i lëvizë ushtarët e tij, gjegjësisht ta japë pëlqimin.

Bashkimi Evropian, ndërkohë, ka thënë se çështja e hapjes së urës së Ibrit duhet të jetë temë e dialogut me Serbinë.

Kjo është kundërshtuar nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila deklaroi të enjten se “një gjë e tillë do të ishte shkelje e rëndë e sovranitetit, integritetit territorial dhe e kushtetutshmërisë në vendin tonë”. “Vuçiqi nuk ka çka pyetet se kur do të hapen urat për qarkullim në Republikën e Kosovës. Dialogu i vetëm që duhet të bëhet është ai brenda Kosovës, në mes të institucioneve tona dhe partnerëve tanë të sigurisë [veçanërisht me NATO-n]”, tha Osmani.

Në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi palët janë pajtuar që ura të hapet për qarkullim, por kjo nuk është realizuar kurrë në praktikë. Është hapur vetëm njëra anë e saj për këmbësorë.

Hovenieri: Quinti dhe NATO-ja s'e mbështesin hapjen e urës së Ibrit në këtë kohë

Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Prishtinë, Jeffrey Hovenier, ka thënë të premtën se vendet e Quintit dhe NATO-ja nuk e mbështesin hapjen e urës së Ibrit në Mitrovicë në këtë kohë. Ai i bëri këto

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri i parë, Besnik Bislimi dhe ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, takoi të premtën ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Jeffrey Hovenier, ambasadorin e Francës, Olivier Guerot, ambasadorin e Italisë, Antonello De Riu, shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Tomaas Szunyog, zëvendësambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Paul O'Connor dhe zëvendësambasadorin e

Gjermanisë, Matthias Conrad. Diskutuan rreth zhvillimeve në vend dhe temave aktuale. Kryeministri i njoftoi me rezultatet e masave dhe politikave të punësimit dhe mirëqenies në katër komunat me shumicë serbe në veri të vendit, konkretisht me masën “Qeveria për familjet”, në kuadër të së cilës deri më tani është ndërmjetësuar dhe mbështetur punësimi i 231 personave në këto komuna. Ndërkohë që interesimi i qytetarëve nga radhët e komunitetit joshumicë serb për t'u pajisur me dokumentet e Republikës së Kosovës ka shënuar rritje në tremujorin e

Incidenti me presidenten në Shkup, pakujdesi e autoriteteve ose provokim

PRISHTINË, 2 GUSHT - Presidencia e Kosovës ka akuzuar autoritetet e Maqedonisë së Veriut për shkelje të praktikave ndërkombëtare dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike, duke thënë se, gjatë 1 gushtit, presidentes Vjosa Osmani është tentuar t'i merret telefoni personal nga një pjesëtar i sigurimit të Aeroportit të Shkupit (TAV). "Presidentja nuk ka lejuar një gjë të tillë, sepse do të ishte shkelje e rëndë", tha këshilltari politik i Osmanit, Bekim Kupina. Autoritetet maqedonase kanë hedhur poshtë këto akuza të Presidencës, por thanë se kanë nisur hetimet për këtë rast. Nga kompania TAV thanë se Departamenti i Sigurisë, në kuadër të përgjegjësive, ka kryer kontroll standard të sigurisë.

Incidenti ka ndodhur para udhëtimit të planifikuar të Osmanit drejt Sllovenisë, ndërsa Presidencia e Kosovës nuk ka bërë me dije nëse qëllimi i udhëtimit të saj ka qenë zyrtar apo i natyrës private. Bekim Kupina tha se, përkundër se i janë bërë të ditura rregullat diplomatike, "ai [sigurimi] ka tentuar fizikisht ta shtyjë presidenten me ç'rast është detyruar të reagojë Policia e Kosovës për ta hapur rrugën". "Kjo sjellje e zyrtarit maqedonas të aeroportit është në kundërshtim me çdo praktikë ndërkombëtare, sipas të cilave, kur krerët e shtetit udhëtojnë, ata mbrohen me privilegje e imunitete diplomatike. Në kundërshtim me këto rregulla, pala maqedonase ka marrë çantën personale të dorës së presidentes", tha Kupina.

Konventa e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike, veç të tjerash, mbron statusin diplomatik, privilegjet dhe imunitetin e krerëve

të shteteve dhe anëtarëve të stafit të tyre në territorin e shteteve të tjera. Në këtë konventë, kur flitet për udhëtimet, thuhet se personave që kanë status diplomatik, dhe stafit të tyre, duhet t'u lejohet lëvizje e lirë. "Në kundërshtim me këto rregulla, pala maqedonase ka marrë çantën personale të dorës së presidentes. Edhe pse kjo ishte kundër rregullave, ekipi i presidentes e ka lejuar në mënyrë që presidentja të hyjë në aeroport, konkretisht në sallën VIP, e cila ishte rezervuar me notë verbale të Ambasadës sonë, siç është praktika për udhëtimet e krerëve të shtetit. Mirëpo, për arsye të sigurisë, në asnjë mënyrë nuk është lejuar të dorëzohet telefoni personal", ka njoftuar Presidencia. Sipas tij, sjellje dhe ngjarje të tilla nuk kanë ndodhur në asnjë udhëtim të Osmanit, përfshirë edhe në shtetet mosnjohëse. "Presidencia e konsideron çdo sulm dhe trajtim të parregullt e në kundërshtim me konventat ndërkombëtare të zyrtarëve të lartë shtetërorë si sulm ndaj shtetit të Kosovës", tha Kupina. "Vlen të përmendet se pas hyrjes së Presidentes në aeroplan, Aeroporti i Shkupit nuk e ka lejuar aeroplanin komercial të niset edhe për më shumë se një orë, me pretekstin se shteti slloven nuk po e lejon nisjen, për shkak se nuk do të ishte gati për aterrim. Kabineti i Presidentes e ka kontaktuar palën sllovene të cilët na kanë informuar që një gjë e tillë absolutisht nuk është e vërtetë dhe se aeroplani do të mund të ateronte në kohën e planifikuar", tha Kupina. "Vërehet qartë se në rastin në fjalë kishte tendencë për ta provokuar delegacionin e Republikës së Kosovës dhe për të shkaktuar incident", tha ai, duke shtuar se për këtë incident është njoftuar kryetari



i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, "të cilin e falënderojmë për ndihmën e ofruar".

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës tha se është informuar për "trajtimin jodinjtëz të presidentes së Republikës së Kosovës" në Aeroportin e Shkupit. Pakujdesi e autoriteteve të Aeroportit të Shkupit apo provokim - këta janë dy skenarë të mundshëm për atë që i ka ndodhur presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, në aeroportin e Shkupit më 1 gusht, thotë për Radion Evropa e Lirë Afrim Hoti, profesor i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës. Kjo, në bazë të informacioneve që deri më tani janë bërë publike. "Po, parimisht, të paktën në bazë të informacioneve që deri më tani kanë dalë në publik, mendoj që janë dy skenarë. Skenari i parë është një pakujdesi e autoriteteve të Aeroportit të Shkupit. Ne kemi parasysh faktin që edhe në Maqedoninë e Veriut edhe në Kosovë, po edhe gjetiu, jo i gjithë stafi që punon nëpër pika kyç, ka përgatitjen e duhur për të kuptuar privilegjet dhe imunitetet diplomatike të autoriteteve publike. Në këtë drejtim, mendoj që skenari i parë pra flet për një

pakujdesi të stafit. Ndërkohë, që ekziston mundësia edhe e ndonjë skenari tjetër që flet eventualisht për provokime të caktuara, të cilat janë të besueshme në rastin aktual për faktin që tashmë atje e kemi edhe elementin serb në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë Veriore dhe që edhe skenarë të tillë eventualisht nuk do të duhej të përjashtoheshin", ka theksuar Hoti.

Shkupi thotë se po kryen hetime

Por, Ministria e Brendshme e Maqedonisë së Veriut tha përmes një njoftimi se përderisa Osmani ishte duke kaluar nëpër kontrollin kufitar, në momentin që asaj iu kërkua që të linte telefonin e saj që të kalonte përmes skanerit, "një pjesëtar i sigurimit të saj është tërhequr nga një punonjës i aeroportit, me qëllim që ajo të kalonte pa telefon të skanuar dhe bagazh dore". "Më pas bagazhi u kthye dhe kaloi përmes një skaneri. Pas gjysmë ore erdhi një person nga siguri i kryetarit të Kuvendit, Afrim Gashi, [polici] me dy persona të tjerë [polici] dhe filluan të kërcënojnë punëtorët e Aeroportit dhe të pyesin se kush i ka shkaktuar problem presidentes", u tha në

njoftim. Ministria tha se po kryen hetime rreth asaj se çfarë ka ndodhur.

Kabineti i Gashit ka bërë të ditur se siguri i tij (punonjës të Ministrisë së Punëve të Brendshme), kanë ndërhyrë për të qetësuar situatën dhe për të ndihmuar kolegët e tyre që të zbatojnë procedurat e sigurisë gjatë vizitës së personave VIP.

Kompania TAV tha në një komunikatë se "si operator aeroporti, ka detyrim ligjor të kryejë një kontroll sigurie të të gjithë udhëtarëve, bagazheve dhe mallrave në fluturimet nga aeroporti ndërkombëtar i Shkupit dhe nga aeroporti i Ohrit, duke përfshirë ata që udhëtojnë nëpër sallonin VIP". "Prandaj, departamenti i sigurisë i TAV-it, në kuadër të përgjegjësive, ka kryer kontroll standard të sigurisë së udhëtarit të përmendur si dhe bagazhit të tij, në pikën e kontrollit të sigurisë në sallonin VIP për të siguruar fluturimin specifik komercial".

Lidhur me këtë ngjarje ka reaguar ish-ministri i Jashtëm i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, i cili tha se dënon "veprimet e papranueshme" që kanë ndodhur në Shkup. "Ky incident tregon qartë paaftësinë dhe papërgjegjshmërinë e përfaqësuesve të paligjshëm shqiptarë në qeveri", shkroi ai në "Facebook".

Aleanca për Shqiptarët dënoi "ashpër provokimin e rëndë ndaj Republikës së Kosovës, përmes sjelljes skandaloze të zyrtarëve të Aeroportit të Shkupit" ndaj presidentes Osmani.

Kosova dhe Maqedonia e Veriut kanë raporte diplomatike dhe deri më tani nuk kanë pasur incident të kësaj natyre.

BDI-ja: Dënojmë skandalin diplomatik ndaj Osmanit, vasalët shqiptarë të paaftë

SHKUP, 2 GUSHT - Bashkimi Demokratik për Integritim (BDI) ka dënuar incidentin ndaj presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, në Aeroportin e Shkupit, duke e quajtur "incident skandaloz diplomatik". "Kjo pasqyrë e shtetit ndaj çdo qytetari, e në veçanti ndaj përfaqësuesve më të lartë të shtetit, e në këtë rast motrat dhe vëllezërit tanë nga Kosova, është e papranueshme dhe duhet dënuar në formën më të ashpër", thuhet në reagimin e BDI-së.

BDI-ja skandaloze e ka quajtur edhe përfshirjen në rast të anëtarit të sigurimit të kryetarit të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi. "Involvimi i shefit të sigurimit të kryetarit jolegjitim të Kuvendit Afrim Gashi në incident, duke e thelluar atë, pa pasur asnjë kompetencë, pa qenë të thirrur dhe pa të drejtë, është gjithashtu skandaloz dhe flet zëshëm për gjendjen e mjerueshme dhe vazale në të cilën është përfaqësimi jolegjitim shqiptar në qeverinë



monoetnike", thuhet në reagim. Për këtë e ka akuzuar koalicionin VLEN. "Humbësit e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare pranuan rolin e të nënshtruarit dhe servilit, vetëm për të qenë në

pushtet për veten e tyre, duke lënë në mëshirën e VMRO DPMNE-së, fatin e shqiptarëve në vend dhe në rajon. Mungesa e legjitimitetit, por edhe e dijës dhe guximit, të bën të turpëroresh para qytetarëve dhe para motrave e vëllezërve në Kosovë e Shqipëri, por edhe në Uashington e Bruksel", thuhet në reagim.

BDI ka thënë se të përfshirët duhet të japin përgjegjësi. "Mohimi i incidentit nga zëvendësministri i Punëve të

Brendshme, Astrit Iseni, involvimi i paligjshëm dhe anarkik i sigurimit personal të Gashit që nxiti incident edhe më të madh, nuk guxojnë të kalojnë pa përgjegjësi politike bashkë me përgjegjësinë ligjore të të gjithë të involvuarve në këtë skandal diplomatik", thuhet në reagim. Osmanit iu tentua t'i merrej telefoni në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit, ndërsa Presidencia e Kosovës ka thënë se pati tentim edhe të shtyhej fizikisht.

komente pas takimit që pati me kryeministrin Kurti. "Përfaqësuesit e Francës, Gjermanisë, Italisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara, së bashku me ambasadorin e BE-së në Kosovë, u takuam sot me kryeministrin Kurti për ta njoftuar se qeveritë tona në konsultim me NATO-n nuk mund ta mbështesin asnjë ndryshim në statusin e tanishëm të urës së Mitrovicës në këtë kohë", tha Hovenieri për gazetarë pas takimit.

Krasniqi: Ideja e qeverisë Kurti për hapjen e urës së Ibrit pa marrëveshje, pjesë e propagandës parazjedhore

Profesori universitar Milazim Krasniqi ka thënë se ideja e qeverisë Kurti për hapjen e Urës së Ibrit pa marrëveshje është pjesë e propagandës parazjedhore. "Si e tillë ajo

ide nuk ka të bëjë me realitetin në terren. Përtej propagandës së Kurtit, ajo ide paraqet rrezik për sigurinë, sepse Ura e Ibrit ka një çerek shekulli që është simbol i konfliktit, i ndarjes dhe dhunës. Fuqia fillestare bllokuese e serbëve lokalë buron prej asaj Ure, që nga qershori 1999. Prandaj kushdo që nxitë krizë të re për Uren e Ibrit, thjesht u bënë shërbim ekstremistëve serbë

dhe regjimit të Beogradit, i cili ka muaj që ka lansuar, jo pa sukses, propagandën për zullumin e Kurtit ndaj serbëve në Kosovë. Sanksionet e Bashkimit Evropian janë dëshmi e atij suksesi të propagandës së regjimit të Beogradit", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ai ka thënë se reagimi i prerë i shteteve të Quintit, i KFOR-it dhe i BE-së paraqet saktësisht

shqetësimin real për rrezikun që ka kjo ide e qeverisë Kurti. "Eskalimi i mëhershëm për targat dhe inaugurimin e kryetarëve lokalë, ku u lënduan shumë ushtarë të KFOR-it, nuk duhet të lejohet më. Kosova ka nevojë për qetësi, paqe dhe marrëveshje me serbët lokalë, që janë shtetas të Kosovës dhe duhet të integrohen me dialog. Nuk mund të integrohen me dhunë", ka theksuar Krasniqi.

Peshimi i forcave të kryeministrit Kurti dhe presidentes Osmani



PRISHTINË, 2 GUSHT - Lëvizja Vetëvendosje nuk me dije pse lideri i kësaj partie, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk është paraqitur për konsultime me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani, për përcaktimin e datës për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta parlamentare.

Më 31 korrik Osmani ka zhvilluar një takim me partitë parlamentare. Presidentja e Kosovës, më pas, në konferencën për medie, tha se nuk e di arsyen e mosparaqitjes së tij dhe sugjeroi që gazetarët ta pyesin vetë.

Radio Evropa e Lirë i është drejtuar Lëvizjes Vetëvendosje dhe kabinetit të kryeministrit Kurti me pyetjen se pse nuk ka shkuar në takim me Vjosa Osmanin dhe si kanë qenë marrëdhëniet e tyre, por nuk ka marrë përgjigje.

Ndërkohë, Kurti në rrjetet sociale ka shpërndarë informacione se më 31 korrik ka drekuar me disa ambasadorë me ftesë të shefit në largim të Zyrës së BE-së në Kosovë.

Analisti politik Visar Ymeri vlerëson se Kurti dëshiron të

paraqitet në publik si figura më e rëndësishme politike dhe për këtë nuk iu përgjigj takimit të thirrur nga presidentja Osmani.

Drejtoresha e Lëvizjes FOL, Mexhide Demolli, thekson se kjo nuk është hera e parë që ka pasur "mosmarrëveshje" ndërmjet kryeministrit Kurti dhe presidentes Osmani, por lëvizja e fundit e liderit të Vetëvendosjes tregon për një "krisje" tjetër në marrëdhënien e tyre.

Një marrëdhënie e tillë, thotë ajo, mund të shkaktojë edhe destabilitetin politik.

Çfarë ndikon në marrëdhëniet në mes të Kurtit dhe Osmanit?

Në një prononcim për Radion Evropë e Lirë, Visar Ymeri tregon se mosmarrëveshjet ndërmjet Kurtit dhe Osmanit janë evidente dhe se një nga arsyt për një gjë të tillë është edhe ministria e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, e cila i është përmbajtur Vetëvendosjes. Gërvalla vjen nga radhët e partisë Guxo, e cila u themelua nga Vjosa

Osmani, pasi ajo u largua nga Lidhja Demokratike e Kosovës në vitin 2020 për shkak se nuk e mbështeti rrëzimin e Qeverisë së Albin Kurtit.

Osmani atëherë ishte kandidate për presidente të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të shkurtit 2021 në listën e Lëvizjes Vetëvendosje dhe mori mbi 300 mijë vota nga qytetarët. Në prill të po atij viti, ajo u zgjodh presidente falë votave të deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje. Mirëpo Visar Ymeri thekson se marrëdhëniet e "acaruara" mes Kurtit dhe Osmanit janë ndikuar edhe nga raporti me vendet perëndimore.

Përkatësisht, Qeveria e kryeministrit Albin Kurti shpeshherë është nën kritika nga bashkësia ndërkombëtare për shkak të vendimeve që merr, të cilat prekin kryesisht pjesëtarët e komunitetit serb dhe për shkak të refuzimit të formimit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Në situata të tilla, Osmani thekson se për të gjitha vendimet është i domosdoshëm koordinimi me

partnerët nga vendet perëndimore.

Diplomati amerikan Gabriel Escobar, i cili deri vonë ishte edhe i dërguari special për Ballkanin Perëndimor, tha në një intervistë për Radion Evropë e Lirë në mars të këtij viti se ka "zhgënjime të mëdha me Qeverinë e Vetëvendosjes, jo vetëm në Uashington por edhe në Bruksel, Romë, Berlin dhe Paris".

Ai tha se në Kosovë ka ende institucione që i kuptojnë qartë marrëdhëniet me Evropën dhe SHBA-në. "E kam fjalën konkretisht për presidenten [e Kosovës, Vjosa Osmani]", tha Escobar.

"Përçarja në marrëdhëniet në mes të Kurtit dhe Osmanit mund të ketë pasoja"

Në një prononcim për Radion Evropë e Lirë, Mexhide Demolli thekson rëndësinë e takimit të thirrur nga presidentja e Kosovës për përcaktimin e datës për

zgjedhje të rregullta dhe shton se vendimi i Kurtit për të mos u paraqitur në të tregon për një përçarje të mundshme në marrëdhëniet e tyre. "Kjo përçarje mund të ketë implikime të rëndësishme për stabilitetin politik dhe qeverisjen", thotë Demolli.

Ajo, po ashtu, tregon se bashkëpunimi ndërinstitucional dhe vendimarrja e përbashkët nga Qeveria dhe Presidenca në shumë fusha, është e paraparë me Kushtetutën e Kosovës. "Pavarësisht këtyre mosmarrëveshjeve mes presidentes dhe kryeministrit, besoj dhe shpresoj se ato do të zgjidhen duke arritur një konsensus të gjerë politik për organizimin e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare", thotë Demolli.

Partitë opozitare kanë kohë që kërkojnë zgjedhje të parakohshme, por nuk kanë arritur marrëveshje se kur duhet të mbahen. Visar Ymeri beson se Lëvizja Vetëvendosje do t'i shtyjë zgjedhjet për aq kohë sa të jetë e mundur "sepse ka frikë nga efektet e rezultateve zgjedhore".

"Them kështu, [ekziston] një lloj momenti vetëdijësues i qytetarëve për mospunën e Qeverisë dhe ky moment vetëdijësues shfaqet më së shumti në dështimet ekonomike dhe sociale, efektin më brutal dhe më të egër të të cilëve e ndiejmë gjatë muajve të dimrit, posaçërisht gjatë festave të fundvitit", thotë ai.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, pas takimit me partitë parlamentare më 31 korrik, ka deklaruar se është rënë dakord që të analizohen të gjitha datat dhe elementet relevante për mbajtjen e zgjedhjeve të rregullta. Osmani ka thënë se partitë kanë pasur propozime të ndryshme për datën e zgjedhjeve, por askush nuk ka insistuar për një të tillë. Disa nga datat e përmendura janë 26 janari ose 2, 9 dhe 16 shkurti.

Viti i ardhshëm 2025 është vit i rregullt zgjedhor në Kosovë dhe nëse partitë politike bien dakord që të mos ketë zgjedhje të parakohshme, qeveria aktuale e udhëhequr nga kryeministri Kurti do të jetë e para që do ta përmbushë mandatin katërvjeçar që nga shpallja e pavarësisë.

Për herë të parë në Kardiologji kryhet një rast me defekt në murin që ndan dy atriumet e zemrës

PRISHTINË, 2 GUSHT - Në Klinikën e Kardiologjisë të Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) për herë të parë është bërë mbyllja perkutane e defektit interatrial në zemër, në mbikëqyrjen e profesor Eustaquio Maria Onorato, me asistim nga stafi i Klinikës së Anesteziologjisë.

Kjo procedurë mjekësore përdoret për të mbyllur një defekt në murin që ndan dy atriumet e zemrës (defekt interatrial).

Në vend se të kryhet një operacion i hapur në zemër, kjo procedurë realizohet përmes kateterëve të futur nëpër enët e gjakut, zakonisht nga këmbët, të

drejtuar deri te zemra. Kjo procedurë është minimale invazive, ka një periudhë më të shkurtër rikuperimi krahasuar me operacionin e hapur. Për të kryer një procedurë të tillë mjekësore pacientët deri tani janë referuar për trajtim jashtë institucioneve publike shëndetësore.



Kurti organizoi pritje për bashkatdhetarë në Ballkonin e Hapur të Qeverisë

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryeministri Albin Kurti ka organizuar pritje për bashkatdhetarët në Ballkonin e Hapur të Qeverisë. Duke u uruar të gjithëve mirëseardhje, fjalën pritëse kryeministri Kurti e filloi me urimin për 25-vjetorin e çlirimit të vendit. "Gëzohem që ju shoh, e gëzuar edhe 25-vjetori i çlirimit të vendit tonë. Ky vit është jubilar e i veçantë, sepse u bë një çerek shekulli në liri. Edhe këtu shprehim mirënjohjen tonë të thellë dhe nderimet tona të larta për të gjithë ata e ato që u sakrifkuan për liri. Përlulisht nga ana jonë,

lavdia u takon atyre, përjetësisht", u shpreh kryeministri. Ai veçoi disa nga nismat kryesore gjatë kësaj qeverisje për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj mërgatës me tarifë e reja për shërbime konsullorë, përfshirjen e tyre në jetën institucionale në vend, përmes Programit për Diplomaci Qytetare mundësitë për investime përmes Dritares për Investime të Diasporës, regjistrimin e mërgatës që po bëhet për herë të parë online përmes platformës Ediaspora dhe programet dhe platformat mirëseardhëse si



ajo "Shijo Kosovën" e cila përmes aktiviteteve të ndryshme gjatë verës me qëllim forcimin e lidhjes së mërgatës me vendin. Kryeministri theksoi se

vullnetin, patriotizmin, gatishmërinë, mërgata jonë e ka pasur përherë. Çka i ka munguar mërgatës, shtoi ai, është "shteti në krahë të saj dhe infrastruktura institucionale që vullnetin e pashtrshëm, patriotizmin shembull dhe gatishmërinë e përhershme, ta kthejë në zhvillim të vendit për më shumë të drejta, për më shumë mirëqenie. E qeveria jonë këtë e di shumë mirë dhe për këtë angazhohemi çdo ditë". Kjo pritje u organizua në kuadër të platformës 'Shijo Kosovën' në shënim të Ditës së Diasporës.

Vdes një grua nga Graçanica pas plagëve që ia shkakttoi bashkëshorti

GRAÇANICË, 2 GUSHT - Një grua me inicialet M. Zh. nga Gushterica e Poshtme e komunës së Graçanicës ka ndërruar jetë më 2 gusht në Qendrën Spitalore Klinike në Prishtinë, pasi burri i saj e kishte rrahur duke i shkaktuar lëndime të rënda. Këtë e ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë drejtori i Qendrës Emergjente në Prishtinë, Naser Syla. "Fatkeqësisht, ajo ka ndërruar jetë mëngjesin e sotëm. Ajo kishte një hemorragji në tru nga lëndimet e rënda dhe ne nuk mundëm ta operonim në atë gjendje. Ajo ishte në makineri 24 orë në ditë", tha Syla.

M. Zh., e lindur më 1983, ishte transferuar në Prishtinë nga Qendra Spitalore Klinike në Graçanicë, ku u pranua në gjendje të rëndë mbrëmjen e 31 korrikut. Policia e Kosovës ka konfirmuar se bashkëshorti i saj me inicialet D. Zh. është ndaluar dhe se ka nisur hetimet për këtë rast.

Aktivistja për të drejtat e grave dhe drejtore të organizatës joqeveritare "Pravo na pravo" nga Graçanica, Milica Stojanović, në një prononcim për Radion Evropa e Lirë tregon se institucionet kanë dështuar sërish kur është fjala për dhunën ndaj grave. "Ky përfundim tragjik ka ardhur



pikërisht sepse institucionet nuk janë marrë sa duhet me këtë problem. Më e keqja është se institucionet ende heshtin. Policia është përgjigjur me kohë, njeriu është dërguar në mbajtje, por varet edhe nga institucionet e tjera se çfarë do të ndodhë", tha Stojanović. Ajo tha se janë institucionet

vendore ato që duhet të punojnë për fuqizimin e grave për të denoncuar në kohë dhunuesin dhe se institucionet e drejtësisë duhet të vendosin dënime më të rrepta për dhunuesit. "Që të mos lirohen dhunuesit me gjobë, dhunuesi nuk duhet të lirohet asnjëherë 24 apo 48 orë pas ushtrimit të dhunës", nënvizon ajo

dhe shton se në raste të tilla duhet të reagojë edhe shoqëria, sepse dhuna nuk është kurrë "çështje private". Gjatë muajit prill dy gra u qëlluan nga burrat e tyre brenda pak ditësh. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, më pas u bëri thirrje institucioneve të sigurojë dhe drejtësisë, shoqërisë civile,

qytetarëve, grave dhe burrave, që të punojnë së bashku për ta ndaluar dhunën me bazë gjinore, "e cila njolllos vendin tonë dhe që mund ta shkatërrojë atë nga brenda". Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024 në Kosovë janë vrarë 57 gra. Në të shumtën e rasteve autorë të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Maqedonci: Investuam mbi një milion euro në ndërtimin e objektit të Akademisë së Mbrojtjes

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka bërë me dije se janë investuar mbi një milion euro në ndërtimin e objektit të Akademisë së Mbrojtjes ashtu që menaxhmenti drejtues e akademik t'i ngrehë kapacitetet profesionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës përmes shkollimit të kuadrove të reja të kadetëve në Qendrën për Studime Universitare dhe avancimin e oficerëve në Shkollën e Oficerëve. "Qendra për Studime Universitare (QSU), e

ndërtuar mbi katër shtylla apo programe kryesore: Programi Profesional; Programi i Udhëheqjes; Programi Akademik dhe Programi i Përgatitjes Fizike, ka për mision të arsimojë, edukojë, trajnojë dhe inspirojë kadetët që të bëhen oficerë të cilët do të udhëheqin me shembull dhe që qëllim kryesor kanë shërbimin ndaj atdheut", ka shkruar ai në "Facebook". Maqedonci ka thënë se janë 43 kadetë të cilët aktualisht po ndjekin studimet në këtë qendër, e të cilët deri në

përfundim të studimeve do të kenë mishëruar në karakterin e tyre vlerat më të rëndësishme si besnikëria, detyra ndaj atdheut, respekti, nderi dhe guximi personal. "Kadetët e diplomuar në Qendrën për Studime Universitare - Akademinë e Mbrojtjes - janë liderët e së ardhmes. Të përgatitur në aspektin fizik e mendor janë të gatshëm për të udhëhequr çdo situatë në mënyrë efektive, pa marrë parasysh mjedisin ose skenarin e operacionit", ka theksuar ministri Maqedonci.



Hykolli: Jemi të shqetësuar me raportet e reja të paraqitura nga ZKA-ja përkitazi me gjetjet në AKP

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryetari i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës, Atdhe Hykolli, ka thënë se janë të shqetësuar me raportet e reja të paraqitura nga Zyra Kombëtare e Auditimit përkitazi me gjetjet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. "Jam i shqetësuar si kryetar i Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës me raportet e reja të prezantuara nga Zyra

Kombëtare e Auditimit përkitazi me gjetjet në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës, gardiani i të drejtave dhe interesave të punëtorëve në Republikën e Kosovës, raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit e sheh si sinjal të mirë për ta vënë në veprim partneren tonë sociale - qeverinë - e cila duhet të



ndërmarrë të gjitha hapat e duhur kushtetues e ligjorë në mbrojtje të së drejtës pronësore

të punëtorëve ndërlidhur me asetet e ndërmarrjeve shoqërore të cilat po tjetërsohen dita-ditës duke ia zvogëluar mjedisin e shëndetshëm të punës punëtorëve në Republikën e Kosovës", ka thënë Hykolli. Më tutje ai thekson se gjëra si këto kur preket siguria dhe prishet mjedisi i shëndetshëm i mirëqenies ekonomiko-sociale të punëtorëve nuk duhen

mbuluar, por duhen qartësuar. "Kur jemi te qartësimi, thërrasim partneren tonë sociale - qeverinë - që t'i ndërmarrë të gjitha masat e duhura për ta vënë në binarë punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit së cilës i janë dhënë në mirëbesim asetet shoqërore - pronat e punëtorëve që janë ngritur me mund dhe djersë", ka deklaruar kryetari i BSPK-së, Atdhe Hykolli.

Paraqiten rezultatet e dy auditimeve të pajtueshmërisë dhe një auditimi të performancës



PRISHTINË, 2 GUSHT - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, në një konferencë për medie ka paraqitur gjetjet dhe rekomandimet e raportit të auditimit të performancës "Vlerësimi i procedurave të shitjes direkte të asetëve në menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit" për periudhën 2019-2021; auditimit të pajtueshmërisë "Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale dhe monitorimi i tyre në komunën e Ferizajt për periudhën 01.01.2022 - 30.09.2023"; si dhe auditimi i pajtueshmërisë "Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave në Ministrinë e Shëndetësisë për vitin 2023".

Po ashtu, Spanca bëri me dije se deri më 31 gusht të këtij viti, në përputhje me planin auditues, do

të kryhen dhe publikohen edhe tri raportet e auditimit të performancës si: Prishtina Parking, pronat e Institutit Bujqësor dhe Lista e pritjes së pacientëve.

Sezoni i auditimit 2023/2024 do të përmbyllet me dërgimin e raportit vjetor të auditimit të buxhetit të shtetit për vitin 2023 në Kuvendin e Republikës së Kosovës si dhe me identifikimin e rasteve me elemente potenciale për mashtrim të cilat do t'i dërgohen Prokurorit të Shtetit. "Duke e vlerësuar si shumë të rëndësishme çështjen e menaxhimit të asetëve publike nga AKP, marrë parasysh që ishte kërkesë e Kuvendit të Kosovës, në sezonin auditues të cilin po e përfundojmë kam përfshirë në plan këtë auditim. Ky auditim ka pasur për qëllim të vlerësojë nëse

procedurat e shitjes direkte të këtyre asetëve janë realizuar në mënyrën e duhur, përkatësisht nëse AKP-ja ka qenë e efektive në trajtimin e kërkesave për shitje direkte, në trajtimin dhe klasifikimin e këtyre asetëve, si dhe në mënyrën se si është bërë përzgjedhja e vlerësuesve për përcaktim të vlerës së asetëve", ka thënë ajo, duke shtuar se auditimi ka nxjerrë në pah se gjatë përmbylljes së shitjeve direkte të asetëve, AKP-ja nuk ishte treguar e efektive pasi që trajtimi i kërkesave për blerje nuk ishte bërë në kohë optimale. "Dobësi kishte edhe procesi i kategorizimit të asetëve të klasifikuara për shitje direkte, është evidentuar se nuk ishte bërë parcelimi si duhet i tokave për shitje dhe në vitet e fundit kategoria e vetme së cilës i ishin

shqyrtuar kërkesat për blerje ishin ekonomitë familjare (personat fizikë)", ka thënë Spanca.

Ajo ka theksuar se auditimi ka evidentuar se nga 118 shitjet direkte të audituara, tek 90 prej tyre kishte ndërtime pa leje e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh) përkatëse ose AKP-së. "Nga 90 mostrat e identifikuar me ndërtime pa leje, në 76 raste NSh/AKP-ja nuk kanë marrë masa për t'i parandaluar ndërtimet pa leje. Ndërsa në 14 raste AKP-ja ka ndërmarrë masa të ndryshme, si: padi gjyqësore, kërkesa për inspektoratin, kallëzim penal, masë të përkohshme. AKP-ja nuk kishte bërë ndonjë analizë të kostos së përfitimeve për të vlerësuar nëse rikthimi i gjendjes paraprake të asetëve në të cilat kishte ndërtime

pa leje do të ishte i leverdishëm", është shprehur Spanca. Ajo në vazhdim ka shpalosur rezultatet e auditimit të pajtueshmërisë "Dhënia në shfrytëzim e pronave komunale dhe monitorimi i tyre në komunën e Ferizajt për periudhën 01.01.2022 - 30.09.2023". Sipas saj, ky auditim kishte për objektive të vlerësojë nëse komuna e Ferizajt ka përcaktuar procedurat dhe format për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës dhe menaxhimin e pronave dhe asetëve të dhëna me qira në përputhje me legjislacionin në fuqi. "Rezultatet e auditimit tregojnë se komuna e Ferizajt nuk ka arritur të ruajë dhe ta rrisë vlerën e pronave të dhëna me qira. Rreth 66 % e mostrave të testuara kanë rezultuar me parregullsi", ka deklaruar Spanca.

Nënshkruhen dy marrëveshje me vlerë 60 milionë euro për financimin e projektit të energjisë solare

PRISHTINË, 2 GUSHT - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, dhe kryeshefi ekzekutiv i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), Bekir Gërguri, kanë nënshkruar dy marrëveshje me vlerë totale mbi 60 milionë euro për financimin e projektit të energjisë solare I (Solar4Kosovo).

Në njoftimin për medie thuhet se ky projekt parasheh ndërtimin e një impianti

fotovoltaik diellor me kapacitet të instaluar deri në 100 MW, që do të prodhojë rreth 152 GWh energji në vit. "Synimi kryesor është rritja e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe ulja e ndikimit në ambient nga prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë. Pjesë e projektit është instalimi i paneleve solare në fushat e ish-deponisë së hirit të KEK-ut, afër termocentraleve. Para instalimit, rreth 150 hektarë

të ish-deponisë së hirit në afërsi të Kosova A dhe deponisë së hirit 'Dragodan' do të rivitalizohen. Përveç kapacitetit të shtuar për prodhimin e energjisë elektrike, ky projekt do ta ndihmojë KEK-un në rritjen e nivelit të menaxhimit të burimeve të energjisë, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve për investime në burime të diversifikuara të energjisë në të ardhmen", ka njoftuar Ministria e Financave.



FLET ROBERT BAER, ISH "SUPER" AGJENTI I CIA-S

'Një marrëveshje si për filma, jemi rikthyer në luftën e spiunëve'



Çfarë ndodhi?

Në pistën e aeroportit të Ankarasë, në një ribërje të pazakontë të filmit "Ura e Spiunëve", grupe burrash dhe grash që nuk mund të ishin më të ndryshëmës tyre, lëvizën në drejtime të kundërta. Nga njëra anë, të burgosurit politikë rusë, të burgosur padrejtësisht për luftën për të vërtetën dhe perëndimorë e rusë me shtetësi të dyfishtë që janë bërë vegla politike, kundër vullnetit të tyre. Nga ana tjetër vrasësit, spiunët, kriminelët kompjuterikë dhe pastruesit e parave që nuk do të mbarojnë dënimin. Një shkëmbim historik i të burgosurve për sa i përket numrit dhe shtrirjes gjeografike. Nuk është parë as në kohën e Luftës së Ftohtë. Gjithsej njëzet e katër të burgosur. Gjashtëmbëdhjetë kundër tetë, plus dy të mitur. Shtatë vende janë të përfshira: Rusia, Bjellorusia, Shtetet e Bashkuara, Gjermania, Sllovenia, Norvegjia dhe Polonia. Plus Turqia e cila veçoi si një zonë e lirë për atë që e përkufizoi si "operacioni më i madh i shkëmbimit të të burgosurve në kohët e fundit". Shtatë avionë u shfaqën nga Lindja dhe Perëndimi, pastaj shkëmbimi që, për një ditë, e shndërroi aeroportin Esenboga të Ankarasë, në një lloj Glieniker Brücke të Mijëvjeçarit të Tretë. Tre amerikanë kthehen në shtëpi: gazetari i "Eall Street

Journal", Evan Gershkovich i arrestuar që nga marsi 2023 për tradhti, gazetarja e Radios Evropa e Lirë Alsu Kurmasheva e cila u arrestua tetorin e kaluar për lajme të rreme dhe marinsi Paul Ehelan, i cili u burgos në vitin 2018. Më tej, gjermani Rico Krieger, i cili muajin e kaluar u dënua me vdekje dhe më pas u fal në Bjellorusi, fluturoi për në Berlin. Dhe nëntë të burgosur politikë rusë gjithashtu do të gjejnë azil në Gjermani, duke përfshirë kundërshtarët Ilja Jashin, Vladimir Kara-Murza dhe Andrej Pivovarov, bashkëthemeluesi i OJF-së "Nobel Peace Memorial", Oleg Orlov, artistja nga Shën Petersburgu Sasha Skochilenko, dhe dy ish-bashkëpunëtorët e Navalny-t, Natalia Fadeeva dhe Lilia Chanysheva. Ndërsa presidenti rus Vladimir Putin priti dje si "patriotë" në aeroportin Vnukovo të Moskës "vrasësin e oborrit", Vadim Krasikov, i cili po vuante një dënim të përjetshëm në Gjermani për vrasjen e një disidenti çeçeno-georgjian në Berlin, dy agjentë të fjetur të demaskuar në Slloveni, Artjom dhe Anna Dultsev së bashku me dy fëmijët e tyre, agjentin e GRU-së Pavel Rubtsov. Hacker-in dhe djalin e një deputeti, Roman Seleznev dhe pastruesin e parave Vladislav Kljushin, spiunin Mikhail Mikushin dhe kontrabandistin Vadim Konoshchenok.

INTERVISTA

"Është shkëmbimi më i madh i të burgosurve që nga Lufta e Ftohtë, i arritur falë punës së madhe diplomatike, të kryer në fshehtësi të madhe. Kur të dalin detajet, do të habitemi, janë gjëra si në filma, Hollywood sigurisht që tashmë po mendon për të. Për administratën Biden është një sukses i rëndësishëm, ata i tregojnë botës se dinë ta bëjnë këtë gjë. Por vetë fakti që e gjithë kjo na kthen në atmosferën e luftës së spiunazhit të kohës së Stalinit më shqetëson shumë". Robert Baer është ish-super agjenti i CIA-s, autor i librit Sleeping eith the Devil (në të cilin u bazua filmi fitues i Çmimit Oscar Syriaana), i cili në filmin e tij më të fundit "The Fourth Man: The Hunt for a Kgb Spy at the Top of the CIA" dhe "The Rise of Putin's Russia", tregon se si tre agjente femra kapën spiunët që kishin hyrë në agjenci duke hetuar shefat e tyre.

Çfarë ju shqetëson?

"Nga pikëpamja e drejtësisë dhe e të drejtave të njeriut është një lajm i mirë: njerëz të pafajshëm janë liruar. Por Vladimir Putini është gjithashtu fituesi këtu. Të liruarit nuk ishin spiunë dhe ai e dinte mirë. Agjentët e CIA-s në Rusi kanë të gjithë pasaporta diplomatike, nëse zbulohen dhe arrestohen ata gjithmonë lirohen menjëherë. Prandaj,

gazetari i "Eall Street Journal" dhe të tjerët ishin pengje. Arrestohet për kalkulime politik, si Brittney Griner. Shkëmbimi, mjerisht, është një dritë jeshile për ta bërë përsëri: rusët tani po i konsiderojnë të huajt dhe kundërshtarët si mall, ata e dinë që metoda funksionon".

A kishte alternativa ndaj negociatave?

"Administrata Biden kishte të drejtë që negocioi, ata njerëz nuk mund të braktiseshin. Por do të nevojiteshin përgjigje më të ashpra sesa thjesht sanksionet. Por ne, ndryshe nga Rusia, jemi një shtet ligjor dhe nuk kryejmë akte të piraterisë arbitrare duke arrestuar njerëz të pafajshëm për t'i përdorur për qëllime të liga. Nuk kemi as vrasës si Vadim Krasikov, një figurë e dyshimtë të cilën Putini donte absolutisht ta sillte në shtëpi".

Pse kujdesej kaq shumë për Krasikovin?

"Është një tjetër demonstrim i pandëshkueshmërisë së tij. Ai dërgoi një vrasës në zemër të Evropës dhe tani fiton lirinë e tij. Simbolikisht, në shtëpi, është një akt i fuqishëm."

Ka edhe disidentë rusë. Pse i la të shkojnë?

"Me sa duket ata nuk janë me


peshë të rëndë, aq sa të kenë nevojë të heshtin si Navalny. Jashtë Rusisë, ata nuk do të shqetësojnë shumë".

Disa javë më parë, Donald Trump tha se Biden nuk do të mund të sillte kurrë Gershkovichin dhe shokët e tij në shtëpi. Çfarë ndikimi do të ketë në zgjedhje?

"Asnjë. Kur amerikanët shkojnë në zgjedhje, ata mendojnë vetëm për ekonominë dhe nuk mendojnë për sukseset në politikën e jashtme, për të cilën qytetari mesatar nuk kupton asgjë. Më së shumti do të shërbejë për të rrahur gjoksin në debate dhe për të thënë se Biden në fund të fundit nuk ishte aq i dobët. Këto operacione kanë rëndësi diku tjetër. Për t'ia dalë, u ndërthurën aleancat dhe interesat e shumë vendeve dhe Shtetet e Bashkuara treguan lidhshmëri në këtë operacion. Në dritën e luftës në Ukrainë, është një shenjë ngushëlluese që amerikanët dhe rusët po flasin me njëri-tjetrin".

A do të ketë ndikim në atë luftë?

"Ne nuk mund të dimë nëse ka ndonjë gjë në marrëveshje që ka të bëjë me Kievin. Nuk e di, një formë neutraliteti, parandalimi i hyrjes së tyre në NATO. Ne do ta zbulojmë, ndoshta, kur të jetë shumë vonë." / bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zogaj: Ndeshjet e 'Euro 2024' ishin të fundit për mua si gjyqtar

PRISHTINË, 2 GUSHT - Gjyqtari i njohur Bekim Zogaj i ka dhënë fund karrierës si gjyqtar i futbollit për të nisur një rrugëtim të ri në Zvicër, por sërish i lidhur me profesionin e tij. Ai në "Facebook" ka bërë me dije se do ta nisë punën si zëvendësues i gjyqtarëve dhe shef i asistentëve në futbollin profesional të Zvicrës. "Çdo gjë

ka një fund. Edhe karriera ime si gjyqtar (asistent). Ishte një rrugëtim i jashtëzakonshëm, ndeshje në 'Euro 2024', në Ligën e Kampionëve, Ligën e Evropës, Ligën e Konferencës dhe Ligën e Kombeve dhe në shumë kampionate të tjera. Pas kampionatit Evropian (Euro 2024) Federata Zvicerane më ka ofruar një

pozitë si zëvendësues i gjyqtarëve dhe shef i asistentëve në futbollin profesional të Zvicrës. Nga data 1 tetor do ta marr këtë detyrë. Paraqitjet në 'Euro 2024' ishin ndeshjet e mia të fundit në arenën ndërkombëtare. Në futbollin zviceran do të vazhdojë deri më 30 shtator. Dua ta

falënderoj familjen, Federatën Zvicerane, Sandro Scharer dhe koleget e tjerë për përkrahjen e tyre gjatë këtyre 14 viteve në futbollin elitare. Një falënderim edhe për të gjithë ju që më keni shkruar, respektuar, motivuar dhe kritikuar, edhe këshilluar gjatë këtij rrugëtimi të shkëlqyeshëm", ka thënë Zogaj.



Distria Krasniqi në fokusin e IJF-së për sukseset në Tokio dhe Paris

PARIS, 2 GUSHT - Në ditën e dytë të Lojërave Olimpikë "Paris 2024", kampionja olimpikë e Tokios në (-48 kg), Distria Krasniqi (KOS), u ngjiti në tatami me -52 kg dhe shkoi deri në finale për t'u stolitur me medaljen e argjendtë. Sajti zyrtar i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos (IJF) ka publikuar një rrëfim për xhudisten Distria Krasniqi, ku fillimisht shkruhej: "Jo shumë xhudistë kanë fituar dy medalje olimpikë. Edhe më pak e kanë bërë këtë në dy kategori të ndryshme. Distria tani është në mesin e tyre".

Distria në Paris e fitoi medaljen e argjendtë në kategorinë deri në 52 kilogramë. Në Tokio 2020 kishte fituar të artën në kategorinë deri në 48 kilogramë. Superitstja kulmore ka folur për rëndësinë e medaljes, duke e cilësuar si një të arritur të madhe. "Isha e dëshpëruar vetëm për pak minuta me të argjendtën, por pasi fola me trajnerin Kuka isha në rregull. Dy kategori, dy finale. Jam e lumtur me rezultatin dhe jam krenare me



veten", deklaroi fillimisht Distria për IJF.

Ajo ka folur edhe për ndjenjën e veçantë pas fitimit të medaljes. Këtë ndjenjë po e përjeton për herë të dytë. "Kam folur me shumë sportiste për ndjenjën pas fitimit të medaljes. Pas Tokios ishte më e theksuar pasi isha shumë e fokusuar dhe të nesërmen u largua e gjitha. Nuk kishte më asgjë për të menduar. Po e ndiej sërish këtu,

një lloj boshllëku, por nuk është aq i madh këtë herë. E di që do të jetë në rregull, kam qenë më herët në këtë situatë. Është realitet i çuditshëm për ne kur e shpenzojmë gjithë energjinë për të arritur në këtë pikë, ia dolëm apo jo, kështu që shpesh nuk ka asgjë para ndeshjes, nevoja për fokus zhduket. Do ta menaxhoj këtë ndjenjë më mirë këtë herë dhe pas disa javësh do të kalohet.

Do ta shijoj këtë rezultat", ka treguar Distria për gjendjen emocionale të saj pas garës në Paris.

Ajo ka konfirmuar se do të vazhdojë stërvitjet, duke mos menduar për Lojërat e ardhshme Olimpikë që janë ende larg. Ka paralajmëruar pjesëmarrjen e tretë në Olimpiadë nëse gjërat shkojnë mirë. "Përfundimisht nuk jam gati për t'u ndalur. Ciklin e ardhshëm do ta marr më me qetësi, ndonëse e kam thënë këtë pas Tokios, po ashtu, por nuk ndodhi kështu. Trajneri Kuka më tha që të mos mendoj për lojërat e ardhshme, të pushoj, të marr kohën e duhur dhe të rikuperohem".

Distria ka treguar se ishte shumë e fokusuar në gjysmëfinale dhe se finalja i erdhi shumë shpejt. Në finale e ka pritur Uta Aben. "Isha shumë e lumtur për fitoren në gjysmëfinale dhe nuk jam rifokusuar për Diyoran. Po ashtu, kam punuar shumë për t'u përballur me japonezen në finale.

Kemi punuar për ta analizuar secilën, sidomos Utan. Kisha kundërshtarë tjetër prej asaj që e kam pritur dhe vetëm pak kohë për ta bërë ndryshimin. Gjithsesi Diyora ishte e fokusuar ndaj të gjithave dhe ishte e shkëlqyer. Ajo e meritoi të artën", ka vlerësuar Krasniqi.

Distria ka folur për rëndësinë e medaljes dhe për kontributin e xhudos për vendin. "Si ekip, jo vetëm një medalje apo rezultat, ne jemi të rëndësishëm për vendin. Medalja e dytë në Lojëra Olimpikë më sjell shumë respekt, po ashtu. Medalja e Majlindës ishte më e madhja për ne. Ishte medalje që ndryshoi jetët. E imja dhe e Norës kanë kontribuar në të gjitha sportet në Kosovë. Sportet e tjera tani kanë investime më të mëdha pasi ne jemi bërë ambasadorë të vendit. E kemi treguar se përmes sportit mund të dalim mbi të gjitha problemet që kemi pasur së fundmi", përfundoi sportistja kulmore Distria Krasniqi.

Kuka: Pensionimi i Lorianana Kukës ishte i planifikuar

PRISHTINË, 2 GUSHT - Kryetari i Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, ka folur për "KosovaPress" nga Parisi, atje ku sporti i xhudos ia siguroi Kosovës edhe dy medalje në Lojërat Olimpikë, duke e quar kështu në pesë numrin total të tyre.

Ai fillimisht foli për pensionimin e Lorianana Kukës, lajm ky që befasoi adhuruesit e këtij sporti, derisa Kuka ka deklaruar se kjo ishte e planifikuar që Lorianana t'i jepte fund karrierës pas këtyre lojërave. "Lorianana e ka pasur të planifikuar pensionimin, kështu që për ne

nuk është befasia, e kemi pritur. Fatkeqësisht, edhe ajo e ka pasur një lëndim së voni, paraqitja e saj vërtet ka qenë e nivelit të lartë, ka pasur një performancë shumë të mirë, e kaloi një luftë të vështirë me sllovenen, edhe luftën e dytë ka pasur gjasa të mira ta kaloj, por ja që fati deshi që ajo në raundin e dytë të diskualifikohet dhe të mbetet me plasmanin e nëntë në këto Lojëra Olimpikë. Si garuese aktive besoj se këtu e përfundon karrierën, për të ardhmen e saj ndoshta të angazhohet si trajner apo diçka tjetër nuk ka vendosur



ende", ka thënë Kuka.

Sa iu përket rezultateve të arritura, Kuka është shprehur shumë i kënaqur me nivelin e sportistëve të treguar në këtë olimpiadë, duke e konsideruar si

një arritje të jashtëzakonshme sigurimin e dy medaljeve elitare. I pari i Federatës së Xhudos pati edhe një thirrje për trajnerin e xhudos, njëkohësisht vëllanë e tij, duke thënë se ai duhet të vazhdojë të punojë edhe më shumë në këtë drejtim për të arritur suksese të tjera me gjeneratat e reja. "Sa i përket Dritonit, ne e dimë që ai është strumbullari i sportit të xhudos, është trajner që është i mirënjohur në të gjithë botën. Edhe pse qëllimi i tij është të arrijë pesë medalje olimpikë, unë besoj

se ai është në moshë të ri dhe do të vazhdojë edhe më me përkushtim dhe këtë e kemi obligim ndaj të rinjve që i kemi në radhë duke pritur për rezultate të reja në olimpiadat e ardhshme, në garat e ardhshme, kështu që Toni do të vazhdojë ta udhëheqë Federatën e Xhudos sa i përket trajnimit", ka shtuar Kuka.

Ai në fund theksoi se me këto rezultate që po arrihen në sport, imazhi i Kosovës është i jashtëzakonshëm përballë federatave të shteteve më të mëdha të botës.

Hendbollistët e rinj po përgatiten për Evropian

PRISHTINË, 2 GUSHT - Pos Përfaqësues U18 të hendbollistëve, edhe Përfaqësuesja U18 e djemve është në vllugun e përgatitjeve. Në drejtimin e

selektorit Bujar Qerimi, trajnerëve Tonçi Drushkoviç e Fatmir Muhaxheri, djemtë tanë po ushtrojnë me përkushtim që të përgatiten sa më mirë për

Evropian. Pikërisht në Kosovë organizohet Kampionati Evropian U18 për hendbollistë. Kampionati (B) për hendbollistët deri në 18 vjet mbahet prej 12 deri më 18 gusht

në Prishtinë. Do të paraqiten shtatë ekipe kombëtare: Kosova, Azerbajxhani, Bullgaria, Britania e Madhe, Luksemburgu, Belgjika e Gjeorgjia.



Qitësja shqiptare Manjola Konini mbyll aventurën në Lojërat Olimpikë

PARIS, 2 GUSHT - Qitësja shqiptare Manjola Konini ka mbyllur aventurën në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ajo mori pjesë në disiplinën 25 metra pistoletë rapid dhe precizion. Në këtë garë ajo u klasifikua në vendin e 37 mes

40 konkurrenteve, duke mos hyrë dot mes tetë finalistëve që do ta vijojnë garën për zonën e medaljeve. Konini fillimisht garoi në disiplinën e precizionit, ku grumbulloi 278 pikë. Në tri raundet e kësaj gare ajo arriti 94 pikë,

94 pikë dhe 90 pikë. Më pas, qitësja shqiptare garoi në disiplinën rapid, ku bëri një paraqitje më të mirë, teksa grumbulloi 291 pikë. Në tri raundet e kësaj gare ajo arriti 97 pikë, 96 pikë dhe 98 pikë. Në total, Konini e mbylli

garën me 569 pikë, duke mos u kualifikuar dot për në finalen e kësaj discipline. Kjo ishte gara e dytë e qitësës kuqezi në këtë Olimpiadë, pas asaj 10 metra pistoletë ajri, ku sërish mbeti jashtë finales.



Andy Murray pensionohet nga tenisi

PARIS, 2 GUSHT - Ikona britanike e tenisit, Andy Murray, u tërhoq nga tenisi profesionist pasi karriera e tij e shquar përfundoi me një humbje në çerekfinalen e çifteve për meshkuj në Olimpiadë. Murray, kampioni dy herë i vetëm në Olimpiadë, dhe Dan Evans humbën 6-2 6-4 ndaj çiftit amerikan të tretë, Taylor Fritz dhe Tommy Paul. Murray, 37 vjeç, konfirmoi para Lojërave të Parisit se do të ishte ngjarja e tij e fundit përpara se të tërhiqej nga sporti. "Jam krenar për karrierën time, arritjet e mia dhe çfarë kam dhënë për sportin", ka thënë ish-numri një i botës Murray, i cili fitoi titujt e US Open në 2012 dhe Wimbledon më 2013 dhe 2016. Pas një përfaqimi të gjatë me Evans, Murray ishte dukshëm emocional për zhurmën e krijuar nga tifozët në Roland Garros që këndonin emrin e tij në shenjë mirënjohjeje. Evans e inkurajoi butësisht shokun e tij të ekipit që të shkonte në qendër të fushës për një herë të fundit dhe Murray përshëndeti të



gjitha anët përpara se të shkonte në dhomën e zhveshjes. Duke folur pak më vonë, Murray ka shtuar se ishte "gati" për të dalë në pension. "Natyrisht që ishte emocionale sepse është hera e fundit që do të luaj një ndeshje konkurruese", ka shtuar ai. "Por jam sinqerisht i lumtur tani. Jam i lumtur me mënyrën se si përfundoi. Jam i kënaqur që

munda të dal këtu në Olimpiadë dhe të përfundoj me termat e mi sepse në disa raste vitet e fundit nuk ishte një siguri", ka deklaruar Murray, i cili u bë profesionist në vitin 2005 si adoleshent, luajti 1 001 ndeshje në karrierën e tij dhe shumë më shumë në dyshe. Ai fitoi 46 tituj ATP dhe udhëhoqi Britaninë drejt fitores në Kupën Davis më 2015.

SHKURT

Rritet vlera e kartonit të Mitajt

Mario Mitaj është një lojtar që po rritet në mënyrë të shpejtë dhe në moshën 20-vjeçare është në formacionin e kombëtares shqiptare. Siç njoftojnë mediet ruse, mbrojtësi që luan për skuadrën e Lokomotiv Moscow thaujse e dyfishoi çmimin e tij profesional, teksa pas Evropianit vlera e tij ka arritur në 3.5 milionë euro, nga 2 milionë që ishte në fillim. Klubi i Premierë Ligës ruse do të donte të fitonte shumë më tepër prej tij, teksa besohet se mund të arkëtojnë 10 deri në 12 milionë euro për lojtarin difensiv. Kjo nuk është ndonjë çudi, sepse Lokomotiv pagoi 3 milionë euro, ndërsa "transfermarkt" e vlerësonte kartonin e shqiptarit, që në atë kohë luante në Greqi, vetëm 500 mijë euro. Së fundmi, në skenë ka dalë edhe emri i Cagliari, gjithashtu në elitën e futbollit italian, por gjithsesi jemi ende pak më larg se mes i korrikut, dhe duhet edhe shumë kohë deri në përfundimin e periudhës zyrtare të transferimeve, në fund të gushtit.

Ndahet nga jeta ish-trajneri i Leicesterit

Ish-trajneri i Leicester Cityt, Craig Shakespeare, ndahet nga jeta në moshën 60-vjeçare. Shakespeare u nda nga jeta këtë të enjte pasi humbi "ndeshjen" më të rëndësishme, atë ndaj kancerit. Ai ishte asistent i Claudio Ranierit në vitin 2016, sezonin kur Leicester fitoi titullin e Premierë Ligës. Shakespeare mori drejtimin e "dhelprave" një sezon më pas, pas largimit të Ranierit dhe drejtoi ekipin e Leicesterit në fitoren e famshme ndaj Sevilas në Ligën e Kampionëve.

Zaniolo paraqitet tek Atalanta: Dua t'i shënoj Realit

Nicolo Zaniolo rikthehet në Itali për t'i dhënë një tjetër drejtim karrierës së tij. Anëtori italian u paraqiti tek Atalanta, teksa theksoi se nuk i sheh bergamaskët si shansin e tij të fundit të karrierës, ndërsa shprehu dëshirën për t'i shënuar gol Realit të Madridit në finalen e Superkupës së Evropës më 10 gusht. "Unë nuk e ndiej shumë presionin. Duhet të jap maksimumin jo vetëm në ndeshje, por edhe në stërvitje. Do t'i ndjek me përpikëri këshillat e trajnerit. Nuk e shoh Atalantën si shansin tim të fundit, por e shoh si një mundësi për t'u rikthyer në versionin më të mirë. Është një shans që nuk dua ta humbas. Objektivi im është të jem 100% ndaj Realit. Ndaj tij kam debutuar më parë, por nuk i kam shënuar. Tashmë me Atalantën dua t'i shënoj gol Realit. Shpresoj t'ia dal", u shpreh Zaniolo.

Katie Ledecky bëhet olimpistja femër më e dekoruar në ShBA

Notarja Katie Ledecky u bë olimpistja më e dekoruar e Shteteve të Bashkuara, pas një natë të zhurmshme noti në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". Ledecky fitoi mbrëmë medaljen e argjendtë në garën 4x200m për femra në shtatë minuta 40.86 sekonda në La Défense Arena. Pas kësaj medaljeje, Ledecky e çon numrin olimpik në 13 medalje - tetë të arta, katër argjendi dhe një të bronzitë. 27-vjeçarja e ruajti gjithashtu titullin e saj në 1500 metra stil i lirë me lehtësi mbresëlënëse të merkurën. Ajo mori medaljen e bronzitë në 400 metra stil i lirë dhe të shtunën do të konkurrojë për të siguruar një tjetër medalje të artë në 800 metra stil i lirë. Ledecky tani ka një më shumë se bashkëkombëset Jenny Thompson, Dara Torres dhe Natalie Coughlin, si dhe australianja Emma McKeon.

Bach sqaron situatën e boksieres algjeriane: Khelif është një grua, konfirmimi shkencor do ta qartësojë çështjen

PARIS, 2 GUSHT - Është padyshim lajmi kryesor, ai i ndeshjes së boksit për femra në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" mes algjeriane Imane Khelif dhe boksieres italiane Angela Carini. Lotët e kësaj të fundit dhe fjalët: "Kjo nuk është e drejtë" bën xhiron e gjithë medieve ndërkombëtare. Për t'i shtuar benzinë zjarrit shërbeu edhe deklarata e kryeministres italiane Meloni, e cila theksoi se ndeshja nuk ishte e barabartë mes dy boksierëve. Shumë media e cilësuan boksierin algjeriane si transjinore, por disa të tjera bën me dije në fakt se Khelif ka lindur femër, por ajo ka doza të shtuara testosteroni në organizimin e saj, gjë e cila ka ndikuar edhe në zhvillimin dhe strukturën e saj. Për të sqaruar më shumë situatën e krijuar, Meloni takoi edhe presidentin e Komitetit Olimpik Ndërkombëtar, gjermanin Thomas



Bach, i cili sqaroi menjëherë pas takimit me kryeministren: "Ishte një takim pozitiv. Biseduam edhe për rastin Carini. Ne ramë dakord të qëndrojmë në kontakt për të 'mirëpritur' të njëjtin formim shkencor dhe për ta bërë situatën më të kuptueshme sepse ajo

(boksierja hiperandrogjene algjeriane Imane Khelif) është një grua dhe ka konkurruar për gjashtë vjet në nivel ndërkombëtar". "Ne ndajmë pikëpamjet dhe biem dakord për sqarimin dhe përmirësimin e sfondit shkencor për të cilin folëm", ka shtuar Bach.

Notarja sllovaqe rrezohet pa ndjenja pas garës individuale në 200 metra stil të përzier

Notarja sllovaqe Tamara Potocka u rrezua teksa doli nga uji dhe u rrethua menjëherë nga personeli mjekësor, i cili e vendosi në barelë për ta dërguar më pas për tretman më të hollësishëm. Potocka është

rrezuar buzë pishinës pasi garoi në Lojërat Olimpikë "Paris 2024". 21-vjeçarja u rrezua mëngjesin e sotëm menjëherë pas një ngrohje kualifikuese të 200 metrave individuale për femra dhe iu dha ndihma e parë

dhe më pas u dërgua me barelë. Ajo u pa me një maskë oksigjeni, ndërsa u dërgua për ndihmë mjekësore më të hollësishme. Personali mjekësor në pishinë tha se ajo ishte e vetëdijshme. "Ajo është e

vetëdijshme, por ne jemi në pritje të informacioneve të reja mjekësore", shpjeguan organizatorët për AFP, duke specifikuar se Potocka po kujdesej nga ekipet mjekësore. Sllovakja e përfundoi e garën e

shtata në kohën 2 minuta e 14.20 sekonda, duke e lënë të eliminuar nga raundi gjysmëfinal. Seria e radhës u shty pak për t'u dhënë kohë shpëtimtarëve për t'u kujdesur për notaren.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Learti Market" SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812056605 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Learti Market" D.O.O. Gjilan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812056605 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Learti Market" L.L.C. with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812056605 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "StatGIS" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 810539398 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "StatGIS" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810539398 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "StatGIS" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810539398 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Thirrja për aplikim
(DHËNJE TË OFERTËS)**

"Bashkim T.Ahmetaj" B.I. me Numer Unik.Biz: 812172667 me seli te biznesit në Adresa: Rezalle , Rruga Muharrem Derguti nr 134 , **komuna Skenderaj**, po kërkon një ofertues/kontraktor/kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për **mallrat/punët/shërbime** këshilluese si në vijim:për kompanit e Interesuara për Ofertim të këtyre Makinerive dhe Paisjeve Bujqësore dhe energji solare:

Nr prokurim 01/2024 dt. 03/08/2024

1. Traktor 4x4 me kabine dhe klime
2. Mulli 500 kg,
3. Mikser per ushqimin e kafsheve 4m3,
4. Presa,
5. Pllug,
6. Mbjelljese Gruri,
7. Makine per mbjellje te misri,
8. Vllaqa Hidraulike,
9. Rimorkio,
10. Energjia Solare.

Kompanitë e interesuara duhet të kontaktojnë direkt tek "Bashkim T.Ahmetaj" B.I. **pronar Bashkim Ahmetaj** (Përfituesi) nëpërmjet e-mailit apo telefonit për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë

Afati për të kërkuar një Ftesë për Kuotim/sqarime tek adresa e cekur më poshtë **(5 ditë nga data e publikimit)**

Afati i dorezimit të Ofertave **10 ditë nga data e pranimit te ftesave** per kuotim, ofertat dorëzohen ne Adresen: Adresa: Rezalle , Rruga Muharrem Derguti nr 134 , **komuna Skenderaj**,
Për Informata Shtesë tel: +38344 668 845
dhe në email adresën: bashkimahmetaj43@gmail.com

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- P.P."Hight Experience" shpall të humbur certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues: 811161489.
- Kol Keqa nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Remzi Pula" Doblibare.
- Firore Nuza Beluli nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit Birra Dukagjini me nr. 810069492
- Afrim Sylejmani nga Gjakova shpall të pavlefshme licencën e punës me nr. KO-00481-01-23. Të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

